

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ka hartuar projektligjin “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, me qëllim rritjen e mbështetjes së biznesit për të forcuar konkurrueshmërinë e tyre dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Deri më sot, ka pasur një interes të ulët në skemat e bashkëfinancimit të AIDA-s, për shkak të mungesës së informacionit nga bizneset, mënyrës së aplikimit, e cila ka qenë nëpërmjet postës dhe jo në formë elektronike, mungesës së shërbimeve mbështetëse për biznesin etj. Për këtë është vlerësuar shumë i nevojshëm rishikimi i kuadrit ligjor për mbështetjen e ndërmarrjeve për të qenë koherent me nevojat e tij. Asnjë mbështetje financiare direkte nuk ekziston në formën e granteve për kërkime dhe zhvillim (R&D). Për më tepër mungojnë programet për të financuar drejtpërsëdrejti bashkëpunimin e ndërmarrjeve dhe akademisë edhe pse si ndërmarrjet si organizatat kërkimore kanë të drejtë të aplikojnë për thirrje për propozime pranë Agjencisë Kombëtare për Kërkim, Teknologji dhe Inovacion (të cilat janë të kufizuara në shumën e fondeve të ofruara për shkak të alokimeve të ulëta të buxhetit të shtetit). Referuar projektraportit të monitorimit të SEE 2020 të RCC-së për vitin 2019-2020, raportohet se gjenden statistika të besueshme dhe gjithëpërfshirëse për kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin (R&D dhe Inovacion) në shtetet e rajonit, si Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, ndërkohë që tri ekonomitë e tjera të ËB (Shqipëri, Kosovë dhe Bosnjë-Herzegovinë) nuk kanë bërë asnjë përparim në këtë fushë.

Ekzistenca e mangësive ligjore për dhënien e fondeve nga AIDA për bizneset. Që prej vitit 2019, Ministria e Drejtësisë është shprehur kundër miratimit të projektvendimit, të propozuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, lidhur me krijimin dhe zbatimin e Fondit të Konkurrueshmërisë. Konkretisht, dispozitat e referuara në projektakt nuk autorizojnë shprehimisht Këshillin e Ministrave për të nxjerrë një projektvendim me përmbajtje të tillë.

Objektivat dhe rezultatet e synuara të projektligjit janë:

- Rritja e mbështetjes për NMVM-të me 50%;
- Rritja e aplikimeve për teknologji të reja nga zero aktualisht në 50% brenda vitit 2022;
- Rritja çdo vit e numrit të ndërmarrjeve të reja me, rritja e numrit të të punësuarve si edhe futja e instrumenteve të reja financiare me 10%, respektivisht për çdo tregues;
- Rritja e shkallës së përthithjes së granteve me 100% nga bizneset.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është pjesë e programit analitik të akteve të parashikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe është në përputhje me programin politik të qeverisë për nismat ligjore dhe nënligjore që duhen ndërmarrë për të përgatitur dhe zbatuar politikatat e qeverisë për zhvillimin ekonomik.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji mundëson krijimin e një kuadri ligjor dhe institucional më të plotë, i cili iu përgjigjet nevojave të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Masat mbështetëse për NMVM-të do të mirëpërcaktohen me ligj për të gjitha ndërmarrjet pavarësisht sektorëve ku operojnë. Në veçanti, referencat e reja ligjore që do të ngarkojnë organin e Këshillit të Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore për mbështetjen e biznesit, duke adresuar të gjitha problematikat ligjore të hasura deri më sot, si edhe do të lehtësojë hartimin e politikave mbështetëse për ndërmarrjet dhe ekosistemin e bizneseve në vend.

Për herë të parë, mbështetja shtetërore për NMVM-të është e strukturuar në format, si vijon:

- Mbështetje financiare nga buxheti i shtetit;
- Mbështetje financiare nga partnerët për zhvillim vendas ose të huaj;
- Garanci shtetërore të huas sipas ligjit në fuqi për borxhin dhe garancitë shtetërore, në zbatim të politikave të veçanta të qeverisë, në përputhje me parimet dhe rregullat fiskale mbi qëndrueshmërinë e borxhit publik si dhe kufizimet e borxhit shtetëror e të garancive shtetërore të huave;
- Shërbime publike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Projektligji përcakton detyrimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve për të administruar një portal elektronik për instrumentet financiare të krijuara me fonde nga buxheti i shtetit dhe me donatorë. Çdo institucion, që ofron mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme ngarkohet që brenda 5 ditëve përpara fillimit të zbatimit të skemës të paraqesë një informacion pranë AIDA-s.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka vlerësuar se zbatimi i kuadrit ligjor ekzistues, konkretisht ligjit nr.8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, i ndryshuar, ka pasur mungesa të hapësirave ligjore për hartimin e skemave të garancisë shtetërore të huas për mbështetjen e kreditimit të ndërmarrjeve dhe, për më tepër, nuk mundëson rregullimin e plotë të bazës ligjore për ofrimin e shërbimeve publike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Më këtë projektligj sigurohet dhënia e mbështetjes shtetërore nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse që do të konsistojë në:

- sigurimin e informacionit;
- këshillimin;
- zhvillimin e biznesit;
- trajnimin;
- zhvillimin profesional apo ritrajnimin;
- dhënien e shërbimeve metodologjike për ndërmarrjet dhe personat fizikë që synojnë të krijojnë një ndërmarrje;
- çdo informacion tjetër për mbështetjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji hartohet në bazë të neneve 81, pika 1, dhe 100 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVË)

Projektligji i propozuar është pjesërisht në përputhje me rekomandimin e Komisionit, i 6 majit 2003, në lidhje me përkufizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla

dhe të mesme (Njoftimi zyrtar L 124 , 20/05/2003 P. 0036 – 0041). CELEX 32003H0361.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përmban 4 krerë dhe 20 nene.

Në nenin 1 përcaktohet objekti i tij, i cili lidhet me përcaktimin e rregullave, masave dhe politikave shtetërore për klasifikimin, nxitjen e krijimit dhe zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në nenin 2 jepet qëllimi i këtij ligji, i cili është të përcaktojë përkufizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, të përdorur në politikat shtetërore për t'i mbështetur ato, si dhe përcaktimi i politikave shtetërore dhe kuadrit institucional rregullator në ndihmë të këtyre ndërmarrjeve.

Në nenin 3 jepen përkufizimet kryesore.

Në nenin 4 jepen rregullat për përcaktimin e kategorive të ndërmarrjeve nisur nga numri i punonjësve dhe tavanëve financiare. Konkretisht:

Ndërmarrjet klasifikohen në: mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe ndërmarrje të mesme, në vijim NMVM.

1. NMVM-të janë tërësia e ndërmarrjeve, në të cilat punësohen më pak se 250 persona dhe realizojnë një shifër afarizmi ose një bilanc total vjetor jo më të madh se 250 milionë lekë.
2. Ndërmarrje e vogël konsiderohet një ndërmarrje me më pak se 50 persona të punësuar, e cila ka një shifër afarizmi ose bilanc total vjetor jo më të madh se 50 milionë lekë.
3. Mikrondërmarrje konsiderohet një ndërmarrje me më pak se 10 persona të punësuar, e cila ka një shifër afarizmi ose bilanc total vjetor jo më të madh se 10 milionë lekë.
4. Ndërmarrje e mesme konsiderohet një ndërmarrje me 50 persona të punësuar deri në 249 persona të punësuar, e cila ka një shifër afarizmi ose një bilanc total vjetor nga 50 milionë lekë deri në 250 milionë lekë.

Për qëllime statistikore ndërmarrjet klasifikohen në:

- a) mikrondërmarrje: 0 deri 9 persona;
- b) ndërmarrje të vogla: 10 deri 49 persona;
- c) ndërmarrje të mesme: 50 deri 249 persona.

Në nenin 5 trajtohet detyrimi për plotësimin e deklaratës për përcaktimin se cilës kategori të NMVM-ve i përket një ndërmarrje që kërkon të përfitojë masë mbështetëse nga burime shtetërore, konkretisht:

1. Ndërmarrjet plotësojnë deklaratën e kategorisë si ndërmarrje autonome, ndërmarrje partnere ose ndërmarrje e lidhur, në të cilën përfshihen edhe të dhënat e përcaktuara në nenin 4, të këtij ligji. Deklarata plotësohet edhe në rastet kur shpërndarja e kapitalit është e tillë që e bën të pamundur identifikimin e zotëruesve. Ndërmarrjet kanë detyrimin për plotësimin/dorëzimin e deklaratës, pavarësisht kontrolleve dhe hetimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për inspektimet.
2. Mënyra dhe forma e deklarimit të kategorisë së ndërmarrjes përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për ekonominë.

Në nenin 6 përcaktohen burimet e të dhënave për llogaritjen e personelit, të vlerës së qarkullimit dhe periudhës së raportimit për NMVM-të.

Në nenin 7 përcaktohet mënyra se si llogaritet numri i personelit për periudhën e raportimit, me qëllim kategorizimin e ndërmarrjeve.

Në nenin 8 përcaktohen rregullat për mënyrën e krijimit të të dhënave për ndërmarrjen. Gjithashtu, është përcaktuar se ministri përgjegjës për ekonominë do të nxjerrë udhëzimin në zbatim të këtij neni.

Në kreun II janë parashikuar format e mbështetjes shtetërore për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

Në nenin 9 janë parashikuar rregullat e dhënies së mbështetjes shtetërore për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, si vijon:

1. Dhënia e mbështetjes shtetërore për NMVM-të, pavarësisht përcaktimeve të bëra në nenin 4, të këtij ligji, mund të bazohet edhe vetëm te plotësimi i kriterit të numrit të personelit, në përputhje me parashikimet në fuqi për ndihmën shtetërore.
2. Ndihma shtetërore dhe ndihma “*de minimis*” jepet në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore dhe zbatohet pas autorizimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore.
3. Mbështetja për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme garanton në çdo rast akses gjinor të balancuar.

Në nenin 10 janë përcaktuar format e mbështetjes shtetërore për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, si vijon:

1. Format e mbështetjes shtetërore, që jepen për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme përfshijnë kryesisht:
 - a) mbështetje financiare nga buxheti i shtetit;
 - b) mbështetje financiare nga partnerët për zhvillim vendas ose të huaj;
 - c) garanci shtetërore të huas sipas ligjit në fuqi për borxhin dhe garancitë shtetërore, në zbatim të politikave të veçanta të Këshillit të Ministrave, në përputhje me parimet dhe rregullat fiskale mbi qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe kufizimet e borxhit shtetëror e të garancive shtetërore të huave;
 - ç) shërbime publike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, sipas përcaktimeve të dhëna në këtë ligj.

Në nenin 11 janë përcaktuar mënyra, qëllimi, kriteret dhe strukturat që do të mundësojnë dhënien e mbështetjes financiare buxhetore, si vijon:

1. Me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 10, të këtij ligji, krijohet fondi për zhvillimin e ndërmarrjeve, i cili financohet nga buxheti i shtetit.
2. Fondi përdoret për dhënien e granteve për NMVM-të, me qëllim zbatimin e programeve që synojnë rritjen e konkurrueshmërisë, artizanatit, zhvillimin e të mësuarit rreth ndërmarrjes, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja si rezultat i kërkim-zhvillimit, zhvillimin e aftësive të ndërmarrjes, inovacionin, rinovimin e teknologjisë, ndërkombëtarizimin dhe zhvillimin e NMVM-ve, mbështetjen e grave sipërmarrëse.
3. Fondi për zhvillimin e ndërmarrjeve administrohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).
4. Procedura konkurruese, krijimi, funksionimi, dhe organizimi i bordit vlerësues të kërkesave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Kriteret e përgjithshme të përfitimit të mbështetjes financiare buxhetore për NMVM-të janë:
 - a) Të jenë person fizik apo juridik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, për jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) muaj;
 - b) Të mos jenë në proces falimentimi;

- c) Të kenë paguar rregullisht sigurimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore;
 - ç) Të mos kenë detyrime ndaj organeve doganore dhe tatimore, në momentin e dorëzimit të kërkesës për përfitim fondi;
 - d) Të kenë dorëzuar deklaratën, në përputhje me parashikimin e dhënë në nenin 5, të këtij ligji.
6. Përcaktimi i masës së përfitimit, kriteret dhe kushtet e veçanta të përfitimit për NMVM-të përcaktohen çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.
7. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) administron një portal elektronik për instrumentet financiare të krijuara me fonde nga buxheti i shtetit dhe me partnerët për zhvillim. Çdo institucion, që ofron mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, ngarkohet që brenda 5 ditëve përpara fillimit të zbatimit të skemës të paraqesë informacion pranë AIDA-s.

Në nenin 12 është parashikuar dhënia e garancive shtetërore të huas. Në rastet kur, në zbatim të politikave të ndërmarra për mbështetjen e kreditimit të ndërmarrjeve, vendoset dhënia e garancisë shtetërore, Këshilli i Ministrave përcakton me vendim fondin, sektorët, si dhe kushtet e kriteret për garantimin e huas për mbështetjen e ndërmarrjeve, me propozim të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për ekonominë.

Në nenin 13 janë përcaktuar si cilat janë shërbimet publike për ndërmarrjet, si vijon:

1. AIDA ofron/siguron shërbimet publike të nevojshme për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. Përveç parashikimeve të dhëna në legjislacionin në fuqi për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, AIDA kryen funksionet e dhënies së informacionit, këshillimit, zhvillimit të biznesit, trajnimit, zhvillimit profesional apo ritrajnimit, dhënies së shërbimeve metodologjike për ndërmarrjet dhe personat fizikë që synojnë të krijojnë një ndërmarrje.
2. Dhënia e shërbimeve publike për ndërmarrjet përballohet nga buxheti i shtetit, brenda tavanëve buxhetore të alokuara për Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve për mbështetjen e ndërmarrjeve.

Në nenin 14 është përcaktuar mënyra e hartimit të raporteve vjetore nga ana e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

Në nenin 15 është përcaktuar referenca ligjore për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve.

Në nenin 16 është përcaktuar se cilat janë burimet e financimit të strategjisë.

Në kreun III është parashikuar ngritja dhe funksionimi i këshillit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

Në nenin 17 është parashikuar qëllimi, përbërja dhe detyrat e Këshillit Konsultativ për ndërmarrjet, si vijon:

1. Këshilli Konsultativ për NMVM-të është organ këshillimor dhe transparence që ngrihet pranë institucionit përgjegjës për ekonominë, me përfaqësues nga organizatat e biznesit dhe institucionet shtetërore.
2. Këshilli kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe përbëhet nga 18 anëtarë me eksperiencë pune jo më pak se 5 (pesë) vite në fushën e ekonomisë dhe në mbështetjen e zhvillimit të biznesit, si më poshtë:
 - 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat;
 - 2 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e ekonomisë;
 - 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen e sipërmarrjes;
 - 1 përfaqësues nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve;
 - 2 përfaqësues nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;
 - 5 përfaqësues të sipërmarrjes dhe biznesit, të përzgjedhur nga organizatat dhe dhomat më të përfaqësuara të tregtisë dhe biznesit;
 - 1 përfaqësues nga Shoqata e Bankave;
 - 1 përfaqësues nga Banka e Shqipërisë;
 - 2 përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë, nga të cilët një përfaqësues nga institucionet publike të arsimit të lartë dhe një përfaqësues nga institucionet jopublike të arsimit të lartë. Përfaqësuesit e institucioneve të arsimit të lartë propozohen nga ministri përgjegjës për arsimin, pas përzgjedhjes me thirrje publike.
 - 2 përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të propozuar nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë.
3. Anëtarët e Këshillit emërohen me urdhër të ministrit, pas propozimit nga institucionet apo organizatat e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, për një mandat 3-vjeçar, me të drejtë riemërimi.

4. Këshilli Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme ushtron kompetencat e mëposhtme:
 - a) Diskuton çështjet që lidhen me mbështetjen dhe zhvillimin e biznesit;
 - b) Jep mendime dhe këshilla lidhur me mbështetjen dhe zhvillimin e biznesit;
 - c) Këshillon lidhur me mënyrën e hartimit të skemave mbështetëse për biznesin, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe strategjisë.
5. Rregulla të hollësishme për kriteret e përzgjedhjes të anëtarëve, për organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Këshillit Konsultativ përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Sqarojmë se Këshilli Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme do të këshillojë ministrinë përgjegjëse për ekonominë për hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të biznesit e investimeve, për prioritizimin e tyre dhe orientimin e duhur në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

Në kreun parashikohen dispozita përfundimtare të projektaktit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Në këtë projektligj janë llogaritur si kosto për buxhetin e shtetit shuma për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme nëpërmjet AIDA-s, në formën e mbështetjes financiare (grante) dhe shërbime mbështetëse (si trajnim, këshillim etj).

- Në vitin 2022 janë parashikuar kosto, gjithsej, 51 500 000 lekë, e cila përfshin grante 50 000 000 lekë, krijimin dhe funksionimin e sektorit të trajnimit 1 500 000 lekë.
- Në vitin 2023 janë parashikuar kosto, gjithsej, 53 000 000 lekë, e cila përfshin grante 50 000 000 lekë, funksionimin e sektorit të trajnimit në shumën 3 000 000 lekë.
- Në vitin 2024 janë parashikuar kosto, gjithsej, 53 000 000 lekë, e cila përfshin grante 50 000 000 lekë, funksionimin e sektorit të trajnimit në shumën 3 000 000 lekë.

KËSHILLI I MINISTRAVE